



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Nr. / No. <u>2013</u>	Nr. i faq/ Br. str / No, pg <u>1</u>	
Data / Datum / Data: <u>03.08.2023</u> Pejë / Peë		

Këshilli Drejtues

Datë: 03.08.2023

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 28.07.2023, morri këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET Rregullorja për Shpenzime të Veçanta për Mbarëvajtje dhe Kryerjen e Detyrave të Punë.
- II. Këtij vendimi i bashkëngjitet Rregullorja për Shpenzime të Veçanta për Mbarëvajtje dhe Kryerjen e Detyrave të Punë.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së
Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu



Vendimi t'i dërgohet: Kryesueses së KD-së, Anëtarëve të KD-së, Rektorit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivës së UHZ-së.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Në bazë të nenit 17, paragrafi 3, neni 23 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka", Rregullores Nr. 06/2023 për kompensimin për udhëtime zyrtare dhe shpenzime të Përfaqësimit, Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në mbledhjen e mbajtur më dt. 28.07.2023 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR SHPENZIME TË VEÇANTA PËR MBARËVAJTJE DHE

KRYERJEN E DETYRAVE TË PUNËS

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë kushtet, mënyrën, kriteret dhe vlerën e kompensimit dhe procedurën për përfitimin e kompensimit për kryerjen e detyrave të punës me qëllim të krijimit të kushteve të punës, caktimi i limiteve, kufizimeve dhe shfrytëzimit racional të Buxhetit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

Neni 2
Shpenzimet e përfaqësimit (shpenzimet e takimeve zyrtare)

1. Zyrtarët publikë, funksionarët publikë dhe kategoritë e tjera të të punësuarave që paguhen nga buxheti i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, kanë të drejtë kur lejohet nga dispozitat e kësaj rregullore, për shpenzimet të përfaqësimit.
2. Të drejtë për shpenzimet e përfaqësimit në kuadër të universitetit e kanë:
 - 2.1 Rektori;
 - 2.2 Kryesuesi i Këllit Drejtues;
 - 2.3 Prorektorët;
 - 2.4 Anëtarët e Këshillit Drejtues;
 - 2.5 Sekretari i Përgjithshëm;
 - 2.6 Dekanët e njësive akademike.

Neni 3

Vlera e shpenzimeve të përfaqësimit

1. Varësisht nga arsyet dhe nevojat e detyrave dhe përgjegjësi të punës, vlera maksimale e shpenzimeve të përfaqësimit për një (1) muaj është si më poshtë:
 - 1.1 Rektori – pa kufizim;
 - 1.2 Kryesuesi – deri në 200 euro;
 - 1.3 Prorektorët - deri në 150 euro;
 - 1.4 Anëtarët e Këshillit Drejtues - deri në 100 euro;

1.5 Sekretari i Përgjithshëm - deri në 100 euro;

1.6 Dekanët e njësive akademike - deri në 100 euro.

2. Zyrtarëve sipas neni 2 paragrafi 2 që ju lejohen shpenzimet e përfaqësimit, kanë të drejtë në një shtesë reprezentacioni në vlerë deri në 100 euro (njëqind euro) në muaj për nevoja të njësisë kërkuese për furnizime me pije për delegacione të ndryshme dhe të ngjajshme.
3. Shpenzimet e përfaqësimit kompensojnë vetëm shpenzimet e takimeve zyrtare dhe nuk mund të përdoren për qëllime të tjera.
4. Të gjitha shpenzimet e përfaqësimit duhen të arsyetohen me faturën përkatëse të nënshkruar nga shfrytëzuesi.

Neni 4 Udhëtimet zyrtare

Për kushtet, mënyrën, vlerën e kompensimit dhe procedurën e përfitimit të kompensimit për udhëtim dhe për qëndrim zyrtar brenda dhe jashtë vendit, vlejnë dispozitat e parapara me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2023 për kompensimin për udhëtime zyrtare dhe shpenzime të Përfaqësimit.

Neni 5 Kompensimi dhe vlera e kompensimit për përfaqësim për komisione dhe grupe punuese

1. Komisionet dhe grupet punuese në kuadër të Universitetit, u lejohen shpenzimet e përfaqësimit, në vlerë maksimale prej 100 euro në muaj.
2. Përjashtimisht paragrafit 1 të këtij neni, grupet punuese të cilat merren me organizime në nivel të UHZ-së, u lejohen shpenzimet sipas planifikimit dhe aprovimit nga Këshilli Drejtues.
3. Shpenzimet e përfaqësimit arsyetohen me listën e pjesëmarrësve dhe raport pune.
4. Kompensimi për përfaqësim sipas këtij nënkupton shpenzimet e udhëheqësit të grupit punues gjegjësisht kryesuesit të Komisionit për nevojat e punës së këtyre grupeve.
5. Shpenzimet për përfaqësim mbulohen në bazë të kërkesës nga Kryesuesi i grupit punues apo Komisionit, të cilin e aprovon ZKA.
6. Shpenzimet e përfaqësimit sipas këtij neni duhet të planifikohen në buxhetin vjetor të Universitetit.

Neni 6 Procedurat administrative të përfaqësimit

1. Shfrytëzuesi e paraqet kërkesën e arsyetuar tek ZKA për aprovim, pesë (5) ditë pune paraprakisht;
2. ZKA e aprovon/refuzon kërkesën dy (2) ditë pune pas pranimit të kërkesës.
3. Shpenzimet e përfaqësimit arsyetohen me faturë dhe lista të pjesëmarrësve.
4. Përjashtimisht, në raste të takimeve të cilat janë nga zyra e Rektorit.

Neni 7
Tejkalimi i shpenzimeve të përfaqësimit

1. Shpenzimet e përfaqësimit të përcaktuara me këtë Rregullore, nuk mund të tejkalohen.
2. Çdo tejkalim nga shuma e lejuar mbulohet nga zyrtari përkatës që ka tejkaluar shumën e përcaktuar me këtë rregullore dhe duhet t'i bëhet ndalesë në page.
3. Shpenzimet e përfaqësimit nuk mund të akumulohen dhe të barten në muajin vijues. Vlera e shpenzimeve mbyllet ditën e fundit të muajit.
4. Përjashtimisht, në raste të jashtëzakonshme, me aprovim paraprak të Këshillit Drejtues, kufizimet e përcaktuara në nenin 3 të kësaj Rregulloreje, mund të tejkalohen vlerat e shpenzimeve.

Dispozitat përfundimtare
Neni 8
Vlefshmëria, zbatimi dhe ndryshimi

1. Për çështjet të cilat nuk janë paraparë dhe nuk janë rregulluar me këtë Rregullore, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi që rregullojnë këtë fushë.
2. Interpretimi autentik të kësaj rregulloreje e bënë Këshilli Drejtues.
3. Kjo rregullore plotësohet dhe ndryshohet në procedurën e njejtë.

Neni 9
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja Nr. 3552/15 për shpenzime të veçanta për mbarëvajtje dhe kryerjen e detyrave të punës.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i UHZ-së.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së.
Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu


